10130
18.10.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

RAPORT
MBI MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË PËR 8-MUJORIN E VITIT 2026.

Bashkia në kuadrin e ushtrimit të funksioneve të saj në përputhje edhe me Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" me ndryshime, Ligjin nr. 68, datë 27.04.2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", në zbatim të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 (me ndryshime), Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore",pika 14 dhe 22 , hartoi këtë raport për monitorimin e zbatimit të buxhetit, për 8-mujorin e vitit 2026.

Gjatë këtij 8-mujori është punuar me gjithë strukturat e bashkisë për të përballuar programin e zhvillimit ekonomik vendor të planifikuar duke synuar një realizim të ardhurash dhe një përdorim sa më efektiv të shpenzimeve në bashki, në çdo Njësi Administrative dhe njësi vartëse.

Buxheti në vetvete është një raport balancues midis të ardhurave dhe shpenzimeve që janë përdorur në interes të qytetarëve lushnjarë dhe që kanë të bëjnë me punime të ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve, zgjerimin e rrjetit të ndriçimit në mjedise publike dhe mirëmbajtjen e tij, rritjen dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, pastrimin dhe përpunimin e mbeturinave urbane, administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore e artistike, në zhvillimin e sporteve, në shërbimin social, në mirëmbajtjen e çerdhe-kopshteve si dhe shkollave, në rehabilitimin e kanaleve dhe tregjeve publike, në mbështetjen dhe nxitjen e biznesit të qytetit.

I.TË ARDHURAT:

Në total duke përfshirë dhe transfertat, të ardhurat e planifikuara dhe të realizuara në mënyrë të përmbledhur për 8-mujorin e vitit 2026 jepen në pasqyrën e mëposhtme:

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-*bashkia_lushnje @ yahoo.com*
Ëeb:ëëë.bashkia lushnje.gov.al

Realizimi i të ardhurave për 8-mujorin e vitit 2026

000 lekë

Nr.	Institucioni	Plani Vjetor 2026	Totali 8/mujor i te ardhurave		%
			Plan	Fakt	
1	Te ardhura e vitit 2026	640,579	428,654	381,021	88.9
2	Te ardhurat e trasheguara v.2025	635,008	557,544	557,544	100.0
3	Transf. pa kushtezuar v.2026	744,828	446,897	446,897	100.0
4	Transf pak.sektoriale v.2026	462,390	277,777	277,777	100.0
	Shuma	**2,482,805**	1,710,871	**1,663,238**	97.2

Siç shihet edhe nga tabela e mësipërme, në total të ardhurat e bashkisë për 8-mujorin e vitit2026 janë realizuar 1,663,238,000 lekë nga 1,710,871,000 lekë të planifikuara ose 97.2% e planit tetë mujor.

Realizimi i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës specifike të marra së bashku është në nivelet 100%. Plani i transfertave (grandeve) është i ndarë në tremujorë, aq sa është dhe përcaktimi në mbështetje të Udhëzimit Plotësues përkatës, sipas të cilit çeljet e transfertave të pakushtëzuara dhe të transfertës së pakushtëzuar sektoriale bëhen 30% në tremujorin e parë, 25% në tremujorin e dytë, 23% në tremujorin e tretë dhe 22% e vlerës së përgjithshme çelet në tremujorin e katërt. Realizimi i të ardhurave të trashëguara për 8-mujorin është në vlerën e 428,654,000 lekë nga 381,021,000 lekë që janë të planifikuara për këtë 8-mujor ose 100% realizim.

Analiza për realizimin e hollësishëm të ardhurave të vetë bashkisë është bërë në vazhdim.

Në total për këtë 8-mujor të ardhurat që i takojnë vetëm Bashkisë janë realizuar 367,764,000 lekë nga 409,553,000 të planifikuara ose 89.8%.

Analiza historike nga viti 2019 deri në 2025 paraqitet si mëposhtë:

- Viti 2025 janë realizuar 494,407,000 lekë nga 613,839,000 lekë të planifikuara ose 80.54%.
- Viti 2024 janë realizuar 501,517,000 lekë nga 613,839,000 lekë të planifikuara ose 81.7%.
- Viti 2023 janë realizuar 471,778,000 lekë nga 586,560,000 lekë të planifikuara ose 80.48%.
- Viti 2022 janë realizuar 421,316,000 lekë nga 584,160,000 lekë të planifikuara ose 72.12%.
- Viti 2021 ishte me realizim 403,795,000 lekë nga 584,007,000 lekë të planifikuara ose 69,1%.
- Viti 2020 ishte me realizim 401,805,000 lekë nga 590,367,000 lekë të planifikuara ose 68.1%.

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Ëeb:ëëë.bashkia lushnje.gov.al

- Viti 2019 ky realizim ishte 382,341,000 lekë nga 585,823,000 lekë të planifikuara ose 65.3 %

Të ardhurate realizuara nga Qendra e Arsimit për kopshte, çerdhe, konvikte, etj për 8-mujorin e vitit 2026 janë realizuar 8,809,000 lekë nga 8,098,000 lekëtë planifikuara ose 108.78%.

Të ardhurat e realizuara nga Qendra e Arsimit për kopshte, çerdhe, konvikte, etj. në vite

- Për vitin 2025 janë realizuar në masën 13,332,000 lekë nga 12,240,000 lekë të planifikuara ose 108.92%,
- Për vitin 2024 janë realizuar në masën 13,206,000 lekë nga 12,240,000 lekë të planifikuara ose 107.89%,
- Për vitin 2023 janë realizuar në masën 9,664,000 lekë nga 12,240,000 lekë të planifikuara ose 78.95%,
- Për vitin 2022 janë realizuar në masën9,489,000 lekë, nga 12,240,000 lekë të planifikuara ose 77.52 %.
- Për vitin 2021 janë realizuar në masën 8,923,000 lekë nga 12,220,000 lekë të planifikuara ose 73 %.
- Për vitin 2020 realizimi ishte 6,053,000 lekë nga 12,200 mije lekë të planifikuara ose 49.6 %, (vit i cili pati ndikim të madh nga pandemia).

Të ardhurat e realizuara nga Ndërmarrja e Pasurisë Publike për 8-mujorin e vitit 2026 janë realizuar 4,432,000 lekë nga 10,000,000 lekë të planifikuara ose 44.32%.

- Për vitin 2025 janë realizuar 6,131,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 47.16%.
- Për vitin 2024 janë realizuar 5,760,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 44.31%.
- Për vitin 2023 janë realizuar 6,299,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 48.45%.
- Vitin 2022 janë realizuar 6,539,000 lekë nga 13,000,000 lekëtë planifikuara ose 50.3%.
- Për vitin 2021 realizimi ishte 6,526,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 50.2 %.
- Për vitin 2020 realizimi ishte 5,891,000 lekë nga 13,000,000 lekë të planifikuara ose 45.3 %.

Të ardhurat e realizuara nga Qendra e Kulturës për 8-mujorin e vitit 2026 janë realizuar 15,300 lekë nga 1,003,000 lekë të planifikuara ose 1.53%.

- Vitin 2025 janë realizuar 23,700 lekë nga 1,500,000 lekë ose 1.58%,
- Vitin 2024 janë realizuar 57,000 lekë nga 1,500,000 lekë ose 3.81%,

- Vitin 2023 janë realizuar 50,000 lekë nga 1,500,000 lekë ose 3.33%,
- Për vitin 2022 janë vetëm 28,000 lekë nga 1,500,000 lekëtë planifikuara ose 1.86 %, me rritje krahasuar me vitin 2021
- Vitin 2021, ku realizimi ishte 6,000 lekë nga 1,500,000 lekë të planifikuara.

Realizimi më i detajuar i të ardhurave vendore paraqitet në tabelën në vijim.

PARASHIKIMI DHE REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR 8-MUJORIN E VITIT 2026

000 lekë

Nr.	*Lloji i të Ardhurave*	*Plani Vjetor 2026*	*Progresiv 8-mujori 2026*		
			Plan	*Fakt*	*%*
	Bashkia				
I	***Të ardhura të taksueshme***				
1	Taksë mbi ndërtesat	97,000	64,623	65,129	100.78
2	Taksë mbi tokën bujqësore	100,000	66,660	40,958	61.44
3	Taksë mbi truallin	20,400	13,600	19,607	144.17
4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	70,300	46,850	50,593	107.99
5	Taksa mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier	180	120	251	208.89
6	Taksa vendore e tabeles ^ Takse Reklame	10,000	6,664	11,910	178.73
7	Taksë mbi veprimtarinë e Bizn.Vogël(Tatim i thjeshtuar mbi fitimin)	-	-	-	-
8	Tarifa për leje transporti&license	5,030	3,356	6,657	198.37
	Shuma I	**302,910**	**201,873**	**195,106**	**96.65**
II	***Taksa të ndara***		-	-	
1	Taksa e kalimit të drejt së pronësisë të pas. paluajt	10,000	6,900	2,677	38.80
2	Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura	36,000	24,000	36,229	150.95
3	Renta minerare	6,900	4,600	1,456	31.65
4	Nga tatimi mbi të ardhurat personale	14,000	9,200	18,593	202.10
5	Transfertë nga MIE		-	-	-
	Shuma II	***66,900***	***44,700***	***58,955***	***131.89***
III	***Tarifa***		-	-	
1	Tarifë (për qëllime biznesi) për zënien dhe përdorimin e hapësirave publike	1,500	1,000	1,115	111.48
2	Tarifë për reklama		-	-	
3	Tarifë për parkim (për zënien dhe përdorimin e hapësirave publike për parkim)	8,000	5,340	6,711	125.67

4	Tarifa pastrimi, higjene dhe ndriçimi	133,279	88,986	77,182	86.74
5	Tarifë për therjen e bagetive	-	-	-	-
6	Tarifë për lëshime vërtetime	4,000	2,662	285	10.71
7	Tarife vendore per dhenie leje mjedisore		-	-	
	Shuma III	***146,779***	***97,988***	***85,293***	***87.04***
IV	***Të ardhura të tjera***		-	-	
1	Qera ndërtese	8,250	5,502	3,600	65.43
2	Qera toke bujqësore & asete	5,190	3,460	2,331	67.37
	Shuma IV	***13,440***	***8,962***	***5,931***	***66.18***
V	***Taksa, tarifa & të ardhura të tjera***		-	-	
1	**Të tjera**	**82,810**	**55,364**	**9,848**	**17.79**
	Te ardhura te tjera nga debitoret	*78,000*	*52,164*	*3,435*	*6.58*
	Te ardhura te tjera te paklasifikuara	*1,810*	*1,200*	*662*	*55.21*
	Tarifa te tjera infrastruktur	*3,000*	*2,000*	*5,751*	*287.54*
2	Të ardhura me destinacion (pullat gj.civile)		-	-	
3	Të ardhura nga shërbimi MZSH	1,000	666	659	98.95
4	Sponsorizime nga organizata jo qeveritare		-	-	
	Shuma V	***83,810***	***56,030***	***10,507***	***18.75***
VI	***Grante dhe transferta të tjera***		-	-	
1	Grante nga qeveri huaja		-	11,972	
	Shuma VI	-	-	***11,972***	
	Bashkia (I+II+III+IV+V+VI)	***613,839***	***409,553***	***367,764***	***89.80***
	Qendra Arsimit	***12,240***	***8,098***	***8,809***	***108.78***
1	Të prindërve për kopshtet e fëmijëve	11,840	7,880	8,809	111.79
2	Të prindërve për konvikte	300	150	-	
3	Të tjera	100	68	0	0.59
	Ndërmarrja e Pasurise Publike	***13,000***	***10,000***	***4,432***	***44 .32***
1	Të ardhura nga vaditja	10,000	8,000	1,474	18.42
2	Të tjera+te ardhura nga parkingu =197	3,000	2,000	2,959	147.93
	Qendra Kulturore & Klubi i Sportit	***1,500***	***1,003***	***15.3***	***1.53***
1	Te Ardhura Nga Biletat	600	400	9.6	2.40
2	Te ardhura nga qeradheniet	800	535	5.7	1.07
3	Te ardhura te tjera	100	68	-	-
			-	-	
	TOTALI (Bashki+3 nd/jet)	***640,579***	***428,654***	***381,021***	***88.89***

Për 8 mujorin e vitit 2026, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Lushnje përfshirë dhe Njësitë administrative Kolonjë, Bubullimë, Krutje, Allkaj, Fiershegan, Karbunarë,

Hysgjokaj, Ballagat, Golem, Dushk, janë realizuar në shumën 381,021,000 lekë kundrejt planit 8 mujor prej 428,654,000 lekë ose **88.89%,** dhe planit vjetor prej 640,579,000 lekë.

- **Ajo që vihet re është një rrtije e konsiderueshme e realizimit të të ardhurave krahasuar me të njëjten periudhë të viti 2025, përkatësisht me 10.48 % në vlerën 44,914,000 lekë.**

TAKSA E KALIMIT TË DREJTËS SË PRONËSISË MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.
Bazuar në këto nivele të taksës janë kryer dhe kalkulimet për parashikimin e saj për vitin 2026, si më poshtë:
Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme planifikuar 8-mujori 2026 *6,900,000* lekë dhe është realizuar *2,677,000* lekë në masën 38.8 %.

Realizimi i kësaj takse kryesisht nga strukturat e ASHK, agjent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arkëtuar.
Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 114 datë 21.11.2025 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore. Administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2026", për planifikimin dhe ndjekjen e kësaj takse është ngarkuar Drejtoria e Planifikimit të Territorit në Bashki.
Në zbatim të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" I ndryshuar, Neni 28 Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, pika 4. Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të Bashkisë ose në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë së data 30 e muajit pasardhës. Agjensia Shtetërore e Kadastrës Lushnje, në të gjithë praktikën e ndjekur nuk ka mbajtur Akt-Rakordimi, duke qenë së është detyrë ligjore e agjentit tatimor, për arkëtimin dhe shpërndarjen e kësaj takse me Bashkinë Lushnje.

TAKSA E VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA

E ardhura nga taksa, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Fier) para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 25 % e të ardhurave vjetore mbasi është zbritur vlera e 5% që i takon agjentit tatimor DPSHTRR.

Taksa e vjetore e mjeteve të përdorura planifikuar 8-mujori 2026 *24,000,000* lekë dhe është realizuar *36,229,000* lekë në masën 150.95 %.

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.
DRSHTRR Fier, në të gjithë praktiken e ndjekur nuk ka mbajtur Akt-Rakordimi me Bashkinë Lushnje ,duke qenë së është detyrë ligjore e agjentit tatimor, për arkëtimin dhe shpërndarjen e kësaj takse me Bashkinë Lushnje.

TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme është planifikuar për 8-mujorin e vitit 2026 në total është 144,883,000 lekë dhe është realizuar 125,693,000 lekë në masën 86.75 %, me mos realizim 19,190,000 lekë. Ky mos realizim ka ndodhur për shkak të problematikave të hasura me subjektet të cilat rezultojnë debitorë, pavarësisht masave të ndërmarra për uljen e debitorëve, Drejtoria e të Ardhurave Vendore është duke punuar me Bankat e nivelit të dytë mbi bllokimete llogarive të subjekteve, për të proceduar me Urdhër Ekzekutimi të shumës.

- ***Taksa mbi ndërtesat*** planifikuar 8-mujori 2026 është 64,623,000 lekë dhe është realizuar 65,129,000 lekë në masën 100.78 %, me tejkalim të planit në vlerën 506,000 lekë.

- ***Taksa mbi token bujqësore*** planifikuar 8-mujori 2026 66,660,000 lekë dhe është realizuar *40,958,000* lekë në masën 61.44 %, me mos realizim 25,702,000 lekë.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nën kategorizime. Si rezultat i reformës administrativo – territoriale, Bashkisë Lushnje i janë shtuar edhe sipërfaqe toke bujqësore që shtrihen në hapësirat e njësive administrative (ish komunave).
Mosrealizimi i treguesit të taksës tokës bujqësore, ka ardhur si pasojë e mos arkëtimit të kësaj takse nga kategoria "familjarë', nga problemet ligjore të cilat ka prona (toka bujqësore) e cila në shumë zona nuk është e azhornuar dhe nuk është bërë menaxhimi, si dhe ndarja e pasurisë të familjaret e tjerë përfitues sipas ligjit 7501.

- ***Taksa e truallit*** planifikuar 8-mujori 2026 është 13,600,000 lekë dhe është realizuar 19,607,000 lekë në masën 144.17 %, me tejkalim plani në vlerën 6,007,000 lekë.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në m^2, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetë deklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror në vit. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

TARIFË PËR ZËNIE TË HAPËSIRËS PUBLIKE

Planifikimi si 8-mujor 2026 është 1,000,000 lekë dhe është realizuar 1,115,000 lekë në masën 111.48 %.

Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në m^2 të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit e indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të taksës për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak e cila përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo etj
- Zënia e hapësirës publike në tregjet publike.
- Zënia e hapësirës publike për organizimin e spektakleve ose panaireve të ndryshme.

TAKSE TABELE DHE REKLAME

Planifikuar si 8-mujor 2026 është 6,664,000 lekë dhe është realizuar 11,910,000 lekë në masën 178.73 % me tejkalim plani në vlerën 5,246,000 lekë.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve, subjekteve të transportit dhe profesionet e lira.
Taksa e tabelës përbëhet :
- Tabelë për qëllime identifikimi
- Tabele për qëllime reklamimi

Taksa e tabelës për qëllime identifikuese ndahet në:
- Tabelë për qëllime identifikimi:
- Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme:
- Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

Mbështetur në realizimin e viteve të mëparshme por dhe në ecurinë e arkëtimit të kësaj takse, janë kryer edhe evidentimet mbi subjektet e kësaj takse.

TARIFA PËR LEJE TRANSPORTI DHE LICENSË

Planifikuar si 8-mujor 2026 është 3,356,000 lekë dhe është realizuar 6,657,000 lekë në masën 198.37 %.

TARIFË PARKIMI

Planifikuar si 8-mujor 2026 është 5,340,000 lekë dhe është realizuar 6,711,000 lekë në masën 125.67 %.

Tarifa për parkimin e automjeteve në vend parkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia e Lushnje për vendqëndrime të mjeteve të rezervuara dhe për taksitë e licencuara. Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 114 datë 21.11.2025 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore. Administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2026", si dhe mbështetur në realizimin e viteve të mëparshme por dhe në ecurinë e arkëtimit të kësaj takse, janë kryer edhe evidentimet mbi subjektet e kësaj tarife.

TAKSA E FJETJES në HOTEL planifikuar si 8-mujor 2026 në vlerën 120,000 lekë dhe është realizuar 251,000 lekë në masën 208.89 %.
Taksa e fjetjes në hotel, bazohet në aktivitetin si motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër me këtë destinacion. Për vitin 2026 është parashikuar niveli i taksës në 70 lekë sipas përcaktimeve në ligj, kjo dhe për faktin së ulja e nivelit të taksës jo vetëm që solli ulje të ardhurave por dhe abuzime nga subjektet duke mos raportuar situatën reale të aktivitetit, kjo dhe për mungesën e kontrollit sistematik nga strukturat përgjegjëse.

TARIFA PËR SHËRBIME PUBLIKE
Tarifa për shërbime publike është planifikuar për 8-mujor 2026 88,986,000 lekë dhe është realizuar 77,182,000 lekë në masën 89.74 %. Ky mosrealizim ka ndodhur për shkak të problematikave të hasura me subjektet të cilat rezultojnë debitorë, pavarësisht masave të ndërmarra për uljen e debitorëve, Drejtoria e të Ardhurave Vendore është duke punuar me Bankat e nivelit të dytë mbi rakordimet e llogarive të subjekteve, për të proceduar me Urdhër Ekzekutimi të shumës, si dhe mos kalimit nga ana e Ujësjellësit të të ardhurave të grumbulluara si agjent për këto tarifa.
Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë tarifat vendore të pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit që mblidhen nga biznesi dhe nga familjet.
Të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin nivel shumë të mirë realizimi. Përveç realizimit në nivel shumë të mirë të tarifave mbi biznesin, efekt në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore ka edhe realizimi i të ardhurave nga tarifat e familjes dhe kjo si rezultat i faturimit të këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm.
Nivel shumë të mirë realizimi shënoi edhe tarifa e regjistrimit për subjektet e rinj të biznesit që tregon punë të mirë të kryer në drejtim të uljes së informalitetit, por që duhen shfrytëzuar të gjitha potencialet në drejtim të regjistrimit të subjekteve që u shmangen detyrimeve tatimore.

TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

Në 8-mujor 2026, janë parashikuar të ardhura nga kjo taksë në vlerën 46,850,000 lekë, dhe është realizuar në 50,593,000 në masën 107.99%.

Në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 114 datë 21.11.2025"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore. Administrimin e tyre në Bashkinë e Lushnjes dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2026", për planifikimin dhe ndjekjen e kësaj takse është ngarkuar Drejtoria e Të Ardhurave Vendore.

Në zbatim të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore "I ndryshuar , Neni 27 Taksa e ndikimit në infrastrukture , *pika 4. Këshilli bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.*

RENTA MINERARE

Në 8-mujor 2026 janë parashikuar të ardhura nga tarife në vlerën 4,600,000 lekë, dhe është realizuar në 1,456,000 lekë në masën 31.65 % .

LIGJ Nr.9975, datë 28.7.2008 PËR TAKSAT KOMBËTARE i ndryshuar, ***pika 4****. Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Përqindja e rentës minerare për përmbajtjen e mineralit metalor në nënproduktin minerar është në masën sa 2/3 e normës së rentës së përcaktuar në shtojcën nr. 2, "Grupi i parë (I) Mineralet metalike" që i bashkëlidhet këtij ligji. (Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.) Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë.* ***Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.*** *Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore. (Ndryshuar me Ligj Nr. 157/2014, datë 27.11.2014. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 195, datë 24 dhjetor 2014.)*

Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Vlera në përqindje e rentës minerare, e përcaktuar në ligjin minerar, ndryshon sipas paragrafëve të parë e të dytë të pikës 4 të nenit 4 të këtij ligji. Përcaktimi i vlerës së rentës së pasurisë minerare, për të gjitha mineralet, sipas përcaktimeve të ligjit, kryhet në përputhje me përcaktimet e bëra në shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Këshilli i Ministrave përcakton procedurat e arkëtimit së rentës minerare dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë i licencuari, eksportuesi, për të vërtetuar çmimin e shitjes. Në mungesë të këtij dokumentacioni, organi i ngarkuar nga ky ligj për arkëtimin e taksës së rentës minerare, bën rivlerësimin, mbështetur në metoda alternative.
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Dega e Doganës Vlore (agjent tatimor), për periudhën Janar-Gusht 2026 në të gjithë praktiken e ndjekur nuk ka mbajtur Akt-Rakordimi, duke qenë së është detyrë ligjore e agjentit tatimor, për arkëtimin dhe shpërndarjen e kësaj takse me Bashkinë Lushnje.

1. Regjistrimi dhe azhurnimi i Regjistrit të tatimpaguesve

Numri i tatimpaguesve në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore për 8- mujorin e vitit 2026 rezulton të jetë sipas të dhënave të tabelës më poshtë :

Njësia	Gjëndja e Subjekteve AKTIVE 01.01.2026		Regjistrime te reja gjate vitit QKB/DPT 2026		Pezullim Aktiviteti gjate vitit QKB 2026		Ç'regjistrime gjate vitit QKB/DPT 2026		Gjëndja e Subjekteve AKTIVE 31.08.2026	
	BV	BM	BV	BM	BV	BM	BV	BM	BV	BM
RAJONI 1	271	83	25	3	6	0	3	2	287	84
RAJONI 2	470	157	43	3	14	0	5	4	494	156
RAJONI 3	446	104	37	1	23	1	14	2	446	102
RAJONI 4	319	128	16	2	10	0	2	1	323	129
RAJONI 5	154	92	18	2	5	1	1	1	166	92
HYSGJOKAJ	23	5	2	0	1	0	0	0	24	5
BALLAGAT	17	2	3	0	0	0	0	0	20	2
GOLEM	84	47	4	0	2	0	2	0	84	47
KARBUNARE	49	11	4	0	1	0	1	0	51	11
BUBULLIME	117	21	4	0	3	0	2	0	116	21
ALLKAJ	62	9	2	0	1	0	2	0	61	9
DUSHK	163	53	12	3	3	0	5	1	167	55
KRUTJE	171	41	10	0	6	1	1	0	174	40
FIERSHEGAN	151	26	14	1	8	0	0	0	157	27
KOLONJE	150	57	9	1	4	1	1	0	154	57
TOTALI	**2647**	**836**	**203**	**16**	**87**	**4**	**39**	**11**	**2724**	**837**
AMBULANTË	223		2		5	4	2		218	

Gjatë 8-mujorit 2026, sipas të dhënave të transmetuara nga QKB/DPT dhe atyre të ngarkuara në sistem, rezulton se:

- Janë regjistruar si tatimpagues të rinj dhe të hedhur në Regjistrin e taksapaguesve 106 tatimpagues nga të cilët 203 tatimpagues si biznes i vogël, 16 tatimpagues si biznes i madh
- Gjatë këtij viti janë tatimpagues të taksës së tokës bujqësore 19,382 fermerë.
- Gjate vitit 2026 janë të regjistruar si tatimpagues të taksës se ndërtesës dhe tarifave familjare 37,384 familje

Realizimi i funksionit të regjistrimit të subjekteve të reja nga sektori i vlerësimit dhe regjistrimit në Drejtorinë e te Ardhurave Vendore bërë nëpërmjet:

- bashkëpunimit me QKB-në për regjistrimin e bizneseve të reja
- bashkëpunimit me DPT dhe DRT Fier për ndryshimet e përgjegjësive tatimore
- mbikëqyrjes së regjistrimit të tatimpaguesve të kategorive OJF, ambulantë, fermerë etj., në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier.

II. SHPENZIMET

Gjatë 8-mujorit të vitit 2026 bashkia së bashku me tre njësitë shpenzuese,ka qenë e angazhuar në realizimin e detyrave të paracaktuara në drejtim të funksionimit të saj dhe të angazhimit përballë qytetarëve, për shërbime cilësore dhe në rritje.

Sipas strukturës buxhetore janë 4 njësi që mbulojnë gjithë aktivitetin e bashkisë:

1. Bashkia me 317 punonjës.
2. Ndërmarrja e Pasurisë Publike, me 300 punonjës.
3. Qendra e Kulturës dhe Klubi Shumë-sporteve, me 64punonjës.
4. Qendra e Arsimit me 421punonjës

Në total:1102 punonjës të miratuar.

Financim nga bashkia në formën e subvencionit merr edhe Klubi i Futbollit "Lushnja 1930" sipas buxhetit vjetor 2026në vlerën prej 40,000,000 lekë.
Pjesë përbërëse e numrit të punonjësve dhe fondeve të mësipërme janë dhe transfertat specifike të arsimit, shërbimit të mbrojtjes nga zjarri, pyjet, ujitja me kullimin si dhe rrugët rurale.

Sipas planit të buxhetit të 8-mujorit të vitit 2026 ndarja sipas llogarive ekonomike, me ndryshimet e bëra është:

- Pagat 687,527,760 lekë.

- Sigurimet Shoqërore Shëndetësore 111,865,947 lekë.
- Shpenzimet operative 521,959,843 lekë
- Investimet 389,517,979 lekë.

Në total buxheti për 8-mujorin e vitit 2026 është 1,710,871,530 lekë.

Theksojkmë se në këtë 8-mujor nuk është përfshirë transferta e ardhur nga Ministria e Financave në vlerë 2,211,241 lekë nga transferta e përgjithshme e pakushtëzuar dhe vlera 1,276,000 lekë nga transferta e kushtëzuar. Këto transferta janë përfshirë në sistemin e SMBV por në Degën e Thesarit nuk është bërë shtesa në buxhet pasi është miratuar në Këshillin Bashkiak në datë 31.08.2026 pjesa e transfertës së kushtëzuar për paga dhe sigurime. Pjesa e transfertes se përgjithshme të pakushtezuar në vlerën 2,211,241 lekë do të përdoret per investim në programin AC129.

Për 8-mujorin e vitit 2026, në mënyrë analitike, sipas artikujve realizimi i shpenzimeve paraqitet:

1. **Shpenzimet korrente:**

Këto shpenzime përbëhen nga:

a. **Shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore (Shpenzime të personelit).**

Bashkia më vete, ka një realizim të shpenzimeve të personelit ku përfshihen Pagat në shumën 200,237,000 lekë nga 254,225,000 lekë ose rreth 78.8% ndërsa sigurimet shoqërore dhe shëndetësorenë shumën 33,174,000 lekë nga 39,935,000 lekë të planifikuara ose 83.1%

Ndërmarrja e Pasurisë Publike ka një realizim të shpenzimeve të personelit ku përfshihen Pagat në shumën 128,181,000 lekë nga 149,515,000 lekë ose rreth 85.7 % dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësorenë shumën 21,324,000 lekë nga 25,868,000 lekë të planifikuara ose 82.4%.

Qendra Kulturore dhe Klubi i Sportit ka një realizim të shpenzimeve të personelit ku përfshihen Pagat në shumën 35,192,000 lekë nga 41,044,000 lekë ose rreth 85.7 % dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësorenë shumën 5,877,000 lekë nga 6,808,000 lekë të planifikuara ose 86.3%.

Qendra e Arsimit ka një realizim të shpenzimeve të personelit ku përfshihen Pagat në shumën 233,821,000 lekë nga 242,745,000 lekë ose rreth 96.3% dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësorenë vlerën 38,839,000 lekë nga 39,254,000 lekë të planifikuara ose 98.9%.

Për sa i përket peshës specifike që zënë shpenzimet e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore kundrejt totalit të shpenzimeve të vitit, shpesh herë gjykohemi për përqindjen e lartë të saj, por kjo vjen për arsye se në transferimin e transfertave specifike gjithë punonjësit që mbulohen nga kjo transfertë erdhën pa asnjë shpenzim tjetër përveç shpenzimit të pagave e sigurimeve.

Në mënyrë të përmbledhur sipas njësive shpenzuese realizimi i pagave është:

në,000 lekë

Nr.	Institucioni	Plani Vjetor 2026	Paga		%
			Plan 8-mujor	Fakt	
1	Bashkia	347,280	254,225	200,237	78.8
2	Ndërmarrja P.Publike	220,117	149,515	128,181	85.7
3	Qëndra Kult.& Klubi Sportit	61,764	41,044	35,192	85.7
4	Qëndra Arsimit	348,945	242,745	233,821	96.3
	Gjithsej	**978,106**	**687,528**	**597,431**	**86.9**

dhe realizimi i sigurimeve shoqërore shëndetësore është:

në,000 lekë

Nr.	Institucioni	Plani Vjetor 2026	Sigurime shoq.shendetesore		%
			Plan 8-mujor	Fakt	
1	Bashkia	59,855	39,935	33,174	83.1
2	Ndërmarrja P.Publike	38,802	25,868	21,324	82.4
3	Qëndra Kult.& Klubi Sportit	10,212	6,808	5,877	86.3
4	Qëndra Arsimit	58,882	39,254	38,839	98.9
	Gjithsej	**167,752**	**111,866**	**99,214**	**88.7**

b. Shpenzimet operative:

Këto shpenzime janë shpenzime bazë për funksionimin e shërbimeve në dobi të komunitetit.
Në thelb të realizimit të shpenzimeve operative është racionalizimi i shpenzimeve administrative duke vënë theksin në funksionet prioritare, si dhe në qëllimin e përdorimit të tyre për realizimin e funksioneve kryesore të Bashkisë. Përdorimi me efikasitet i këtyre shpenzimeve ka qenë dhe mbetet një prioritet i punës së drejtuesve të kësaj bashkie.
Pjesën më të madhe të këtyre shpenzimeve e përbëjnë shërbimet publike vendore si: pastrimi dhe gjelbërimi i qytetit dhe njësive administrative, arsimi bazë para universitar dhe mirëmbajtja e rrugëve. Gjithashtu në buxhetin e shpenzimeve operative për vitin pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë shpenzimet bazë të funksionimit si: energji elektrike, ujë, shpenzime për pagesat e këshillit bashkiak dhe kryetareve të fshatrave, qiratë e objekteve dhe të pastrehëve, fondi rezervë dhe i kontigjencës, shpronësimet, shpenzimet postare dhe të rrjetit kompjuterik, emergjencat civile etj., pa përfshirë këtu subvencionin e futbollit.

Për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh, realizimi për 8-mujorin e vitit 2026 i shpenzimeve operative sipas njësive shpenzuese paraqitetsipas tabelës së mëposhtme:

në,000 lekë

Nr.	Institucioni	Plani Vjetor 2026	Shpenzime operative		%
			Plan 8-mujor	Fakt	
1	Bashkia	135,355	104,981	54,682	52.1
2	Ndërmarrja P.Publike	418,347	316,556	154,659	48.9
3	Qëndra Kult.& Klubi Sportit	31,080	24,792	14,711	59.3
4	Qëndra Arsimit	51,660	38,630	25,648	66.4
5	Subvencione futbolli	40,000	37,000	36,593	98.9
	Gjithsej	**676,442**	**521,960**	**286,293**	**54.8**

Në zërin e shpenzimeve operative është i përfshirë edhe fondi i emergjencave civile. Krahas shpenzimeve të përmendura më sipër, këtu përfshihen edhe shpenzimet për karburant, mirëmbajtje ndërtesash, mirëmbajtje rrugësh, ushqimet për kopshte, çerdhe, konvikt dhe Qendrën e Zhvillimit, siguracione mjetesh e pjesë këmbimi, kancelari, shtypshkrime, mirëmbajtje kanalesh, projekte kulturore, etj.

Ndjekja e shpenzimeve operative, bëhet në mënyrë analitike nga njësitë shpenzuese, sipas planifikimit të miratuar në buxhetin e vitit 2026.

Disa nga investimet kryesore të 8-mujorit të parë të vitit 2026 janë:
1.Ndërtim i qëndrës shëndetësore Fiershegan
2.Urbanizim i Bllokut të banimit në Lagjen "18 Tetori": 1-Rruga "Myfit Vokopola" 2-3.Rruga "Altin Mino", 3-"Degëzimi djathtas i segmentit rrugor "Altin Mino", 4-"Rruga "Gani Dranga"+Supervizimi,Kolaudimi
3.Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës "Iljaz Ahmeti"+Supervizimi,Kolaudimi
4.Ndërhyrje në infrastrukturën e rrugës "Iljaz Ahmeti"+Supervizimi,Kolaudimi
Sistemim - Asfaltim i rrugës "Golem i Madh"-"Golem i vogel"+Supervizimi,Kolaudimi
5.Rikonstruksion u godinës Ish Posta Kolonjë+Supervizimi,Kolaudimi
6.Ndërtim i godinës së re të MZSH+Supervizimi,Kolaudimi
7.Ndërtim i varrezave të reja, Lagja Çlirimi, Faza 2+Supervizimi,Kolaudimi
8.Urbanizim i Bllokut të banimit në Lagjen "Gafurr Muco": 1-Rruga "Myzeqeja" 2-Rruga "Topalltia", 3-"Hamit

Realizimi i investimeve sipas njësive shpenzuese është:

në,000 lekë

Nr.	Institucioni	Plani Vjetor 2026	**Investime**		%
			Plan 8-mujor	Fakt	
1	Bashkia	624,005	353,018	161,440	45.7

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Ëeb:ëëë.bashkia lushnje.gov.al

2	Ndermarrja P.Publike	22,500	22,500	5,820	25.9
3	Qendra Kult.& Klubi Sportit	3,000	3,000		-
4	Qendra Arsimit	11,000	11,000	1,901	17.3
	Gjithsej	**660,505**	**389,518**	**169,160**	43.4

Në total sa u analizua më sipër realizimi i shpenzimeve sipas ndërmarrjeve të varësisë paraqitet:

në.000 lekë

Nr.	Institucioni	Plani Vjetor 2026	Totali i shpenzimeve		%
			Plan 8-mujor	Fakt	
1	Bashkia	1,166,495	752,159	449,533	59.8
2	Ndërmarrja P.Publike	699,767	514,439	309,984	60.3
3	Qëndra Kult.& Klubi Sportit	106,056	75,644	55,780	73.7
4	Subvencione futbolli	40,000	37,000	36,593	98.9
5	Qëndra Arsimit	470,487	331,629	300,208	90.5
	Gjithsej	**2,482,805**	**1,710,872**	**1,152,099**	**67.3**

Buxheti i 8 mujorit të vitit 2026 është i planifikuar me 5 programe dhe një program për fondin rezervë dhe të kontigjencës.dhe ndjekja e tij bëhet sipas destinacionit të burimeve (grant-01, të ardhura -05, të ardhura jashtë limitit-06 (Kapitull: 01; 05; 06)etj., dhe për çdo njësi shpenzuese. Realizimi i shpenzimeve për 8 mujorin e vitit 2026 sipas këtyre programeve, jepet sipas tabelës së mëposhtëm:

Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin e parë të vitit 2026 sipas programeve

Programi	Emertimi	Plani vjetor	Plani	fakti	%
AA129	Menaxhimi dhe Shërbimet Mbeshtetese	546,416,571	415,132,564	269,371,800	64.89
AB129	Shërbime Publike Komunitare	1,205,779,513	761,718,747	422,779,298	55.50
AC 129	Arsimi	512,486,529	366,613,082	332,530,224	90.70
AD 129	Zhvillimi Bujqësor, Ekonomik dhe S…	59,780,248	42,477,090	35,044,232	82.50
AE 129	Art, Kultur, Sport & Turizem	148,462,173	115,050,047	92,373,081	80.29
AF 129	Rezerva dhe Kontigjenca	9,880,000	9,880,000	-	-
Total		**2,482,805,034**	**1,710,871,530**	**1,152,098,636**	**67.34**

Krahas realizimit total sipas programeve, shpenzimet janë ndjekur nga çdo njësi shpenzuese në mënyrë analitike dhe sipas klasifikimit buxhetor, sikurse janë përcaktuar edhe në buxhetin vjetor. Realizimi i shpenzimeve për 8-mujorin e vitit 2026 janë në masën 67.34% ose **1,152,098,636** lekë nga **1,710,871,530** lekë të planifikuara. Kjo masë realizimi është e lidhur ngushtë edhe me

realizimin e të ardhurave gjithsej të bashkisë, me kohën e kryerjes së investimeve si dhe nga faktorë të tjerë.
Investimet janë të analizuara me programe të veçanta dhe duke qenë se kontratat janë të regjistruara në sistemin e thesarit, gjatë likuidimit ruhet burimi i të ardhurave sipas specifikimeve të kryera në kontratë. Fakti që në buxhetin e vitit planifikohet 40 % e transfertës së pakushtëzuar për investimeve, ka bërë që gjatë vitit 2026 të ulet ndjeshëm edhe detyrimi ndaj investitorëve për këtë grup shpenzimesh. Realizimi i shpenzimeve sipas përqindjes së mësipërme është i ndarë dhe sipas programeve të planifikuara në buxhet.

Realizimi i shpenzimeve sipas përqindjes për disa nga programet është: Menaxhimi dhe Shërbimet mbështetëse në 64.89 %, Shërbime Publike Komunitareka një realizimi prej 55.5%, Arsimi ka një realizimi prej 90.7 %, Zhvillimi Bujqësor, Ekonomik dhe Sociale kanë një realizim të shpenzimeve në 82.5 %, Art kultura dhe Turizmi me 80.29% . Rezerva dhe Kontigjenca është përdorur fondi ne vlerën 3,120,000 lekë.

Nisur nga fondet që alokohen sipas çdo programi, vlerën më të madhe të realizimit e ka programi "Arsimi" 332,530,224 lekë me 90.7% të totalit të shpenzimeve sipas planit 8-mujor, në vend të dytë programi "Zhvillimi Bujqesor, Ekonomik dhe Social" 35,044,232 lekë ose 82.5% të totalit të shpenzimeve sipas planit 8-mujor, në vendin e tretë është programi "Art, Kultur, Sport&Turizem" me 92,373,081 lekë ose 80.29% të totalit të shpenzimeve sipas planit 8-mujor, në vend të katërt programi "Menaxhimi dhe Sherbimet Mbështetese" me 269,371,800 lekë ose 64.89% të totalit të shpenzimevesi pas planit 8-mujor dhe në vend të pestë programi "Sherbime Publike Komunitare" me 422,779,298 lekë ose 55.5% të totalit të shpenzimevesipas planit 8-mujor.

Pjesë e këtyre shpenzimeve është dhe **Rezerva dhe Kontigjenca**.Pavarësisht se në tabelën e realizimit del 0 lekë, në të fakt këto fonde janë përdorur sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak nr. 07, datë 22.01.2026 në vlerë 140,000 lekë; nr. 08, datë 22.01.2026 në vlerë 280,000 lekë; nr. 10, datë 22.01.2026 në vlerë 700,000 lekë, nr 42 datë 27.04.2026 në vlerë 1,000,000 lekë nr 56 datë 25.06.2026 në vlerë 300,000 lekë, nr 58 datë 25.06.2026 në vlerë 700,000 lekë
Nga 13,000,000 lekë që ishte plani vjetor në fillim, ka shkuar në 9,880,000 lekë. Rezerva dhe Kontigjenca është pakësuar në vlerën 1,120,000 lekë dhe është shtuar në Qendrën e Kulturës dhe Klubi i Shumësporteve ne programin AE129 dhe në Bashkinë Lushnje në Programin AA129.
Hollësi të mëtejshme lidhur me aktivitetin e tyre dhe realizimin e detyrave mund të japë çdo njësi shpenzuese me kërkesën e paraqitur edhe nga Këshilli Bashkiak.

Për çdo fillim muaji me Degën e Thesarit Lushnje,bëhen rakordimet përkatëse si për të ardhurat ashtu edhe për shpenzimet. Gjendja që mbetet trashëgohet për muajin pasardhës. Dhe nga viti në

vit pjesa e të ardhurave që trashëgohet përdoret kryesisht për likuidimine detyrimeve të prapambetura.

Detyrimet këtë 8- mujor paraqiten si me poshtë:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë
II	**Detyrimet e prapambetura**	**23,533,973.74**
Llogaria ekonomike	**Emërtimi**	
4864100	Vendime Gjyqesore	0
4864200	Det.Prap. Sherbime	3,117,440.43
4864201	D.P.EneriElektirke	
4864300	Det.Prap.Mirembajtje	3,618,125
4864400	Det.Prap. Investime	15,599,158.31
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH	
4864600	Mallra	1,108,920
4864900	Det.Prap.Te Tjera	
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore	
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet	
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal	
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera	
4864901	Paga	
4864902	Shpronesime	90,329
4864903	Trans.indiv	
4864904	Trans.Subjektet	
III	**Totali (I+II)**	**23,533,973.74**

Në mënyrë të përmbledhur **realizimi i treguesve financiarë për 8 mujorin e vitit 2026** janë sipas tabelës në vazhdim:

Në lekë

Nr.	Treguesit financiarë	Fakti 8/mujor v. 2026
	Shpenzimet e përgjithëshme	1,152,098,636
	Të ardhurat e përgjithëshme	1,663,238,491
1	**Raporti ne %**	**69.3**
	Të ardhurat e veta vendore	938,564,859
	Të ardhura të përgjithëshme	1,663,238,491
2	**Raporti ne %**	**56.4**
	Shpenzimet kapitale	169,160,359
	Shpenzimet e përgjithëshme	1,152,098,636
3	**Raporti ne %**	**14.7**

	Shpenzimet e personelit	696,645,245
	Shpenzimet e përgjithëshme	1,152,098,636
4	**Raporti ne %**	**60**
	Detyrime tatimore të paarketuara në kohë	47,633,000
	Të ardhura tatimore (Të ardhurat e veta-plan)	428,654,000
5	**Raporti ne %**	**11**
	Shpenzimet për politikat e kujdesit social	16,507,833
	Shpenzimet e përgjithëshme	1,152,098,636
6	**Raporti ne %**	**1.4**
	Detyrimet financiare të pa paguara në kohë	23,533,973
	Të ardhura të pergjithëshme (plan 2026)	2,482,805,034
7	**Raporti ne %**	**0.95**

Hollësi të mëtejshme lidhur me aktivitetin e tyre dhe realizimin e detyrave mund të japë çdo njësi shpenzuese, bazuar edhe në të dhënat e raportuara në monitorimin e performances në SMBV.

DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

Donald NUSHI

DREJTOR

DREJTORIA E FINANCËS dhe BUXHETIT

Ervisa Çuko

DREJTOR

Adresa: Lagjia Kongresi I Lushnjes
Tel.fax :+3553522028
e-mail:-bashkia_lushnje @ yahoo.com
Ëeb:ëëë.bashkia lushnje.gov.al